

THOMA LEKA

E FOLMJA E KUDHËSIT

Kudhësi, është i vetmi fshat në krahinë, që ka qenë i “larguar” nga syri i udhëtarëve, ushtrive dhe vizitorëve. Gjashtë kilometra larg vijës bregdetare e kanë bërë të jetë mbështetja në prapavijë, kur i është dashur më shumë krahinës dhe historisë së saj.

Komunikimi, këngët, shprehjet, pasuria gjuhësore, format e të shprehurit janë sa të përfshira, aq edhe të veçanta, sepse Kudhësi Perivoli është “porta”, që lidh Krahinën me Kurveleshin e Lumin e Vlorës, ku komunikimi ka qenë i afërt për shkak të natyrës baritore.

E folmja e Kudhësit është shtrati konservativ, ku ruhen ende format e vjetruara të gjuhës, të veçorive të leksikut, si edhe theksit të fjalëve në këngë, bejte, humor, vaje, shprehje e ligjërim. Kjo pasuri gjuhësore e leksikore është studiuar e vrojtuar në sipërfaqe, se kanë munguar studimet e thelluara.

Kudhësi, si trevë interesante gjuhësore, me të folme të veçantë, të vonuar në trajta gjuhësore dhe të “përzier”, ngjall interes studimi. Lidhjet njerëzore nga shtegtimi i bagëtime, tregtia e produkteve blegtorale, shkëmbimi i ullinjve, portokajve, fiqve të konservuar, frutave, rakisë dhe verës kanë bërë që të marrë, por dhe të lerë gjurmë fonetike në fjalë e shprehje. Ka qenë urë komunikimi e mirëkuptimi për të gjithë ata që i zuri halli, nata apo ua kërkoi mbijetesën. Veçoritë gjuhësore që vërehen janë fonetike, gramatikore, leksikore, ku vihet re ruajtja e formave të vjetra.

Përdorimi i zanoreve *i* dhe *u* në vend të zanores *y* është tipar gjuhësor i së folmes së Kudhësit si: *it: iti të kërren sitë* (yti të nxjerr sytë), *mbit: u mbit në një lugë ujë* (u mbyt në një lugë ujë), *si: mbill një si kur duhet* (mbyll një sy kur duhet), *grikë: u do flas, por m’u zu grika* (unë do flas, por m’u zu gryka), *ill: të di si ije janë* (të dy si yje janë), *pështimë: folë e folë, iu tha pështima* (fol e fol, iu tha pështyma), *pill: vamë në pill për dru* (vajtëm në pyll për dru), *mbill: ki u mbill brënda* (ky u mbyll brenda), *qiç: kjo punë u bë qiç* (kjo punë u bë kyç), *hij, qiçe: hiri prilli, këndon qiçja* (hyri prilli, këndon qyçja), *gjismë: më tutje se gjismë viti* (më tutje se gjysmë viti), si dhe: *burek: një burek me lakëra* (një byrek me lakra), *dufek: që zure dufek me gra* (që zure dyfek me gra), *dushek: mbusha një dushek me kashtë* (mbusha një dyshek me kashtë), *qimur: bëra plot qimur druri* (bëra plot qymyr druri).

E njëjta dukuri e përdorimit të *i* për *y* ndodh edhe në grupin zanor *ie: po ngjiej me mavri* (po ngjyjej me mavri), *kish lier muret me këlqere* (kishte liyer

muret me gëlqere), *i rrëmbien me forcë* (i rrëmbyen me forcë), *i këcien si soji që ka* (i kërcyen si soji që ka), *se është i rrëmbier* (se është i rrëmbyer).

Përdoren trajta të vjetra si: *dolla korba të pëjesë* (dola e zeza të pyes).

Përdorimi i zanores *ë* të theksuar në vend të zanores *e* para një zanoreje hundore si: *gjëmb: rri si mbi gjëmbe* (rri si mbi gjemba), *mënd: ka tru, po s'ka mënd* (ka tru, po s'ka mend), *dhën: është çoban me dhën* (është çoban me dhen), *dhëmb, zëmër: më dhëmbi në zëmërë* (më dhemb i në zemër).

Përdorimi i zanores *ë* të dikurshme në fund të fjalës: *m'u bë gjarpërë* (m'u bë gjarpër), *hipa në kumbullë* (hipa në kumbull), *i ngjata dorënë* (i zgjata dorën), *i hëngërr kukënë* (i hëngri kokën), *maja e Gjinikësë* (maja e Gjinikës), *grika e Stogoitë* (gryka e Stogoit).

Përdorimi i formave të vjetra foljore si: *shokë, ç'u dehta* nga vera (shokë, ç'u deha nga vera), *ç'i mbëllite* ata si, (ç'i mbylle ata sy), *qethim* një kope të tërë (qethëm një kope të tërë).

Përdorimi i aoristit sigmatik në foljet *gjej, vij, fle*: *mos të gjeça, po arçë* prapë, *fjeçë* tre sahat.

Ka emra bimësh, barërash, shkurresh, sendesh e veprimesh të formave të vjetra si: *bukëthep/e-ia, barkamut/e-ia, glluç-i, purriq-i, përkalidh/e-ia, kuçumbel/e-ia, nuselal/ë-a, argal/i-a, faqefurrash-i, kërkal/e-ia, gënuq-i, heqëkeq-i, kufar-i, mbarsëlis/e-ia, garbun-i, brimadh/e-ia, kukul-i*.

Përdoren gjithashtu fjalë e trajta të përbashkëta me të folme të tjera si: *daj (ndaj), i grinjë (i grunjë), ū (uri), ú (unë), çit (kreh), çit (gris), çit (ndaj), e ndorme (e mburjtur me dorë)*, p.sh.: *kam bukë të ndorme (kam bukë të bërë me dorë), prit, sa të çit flokët (prit sa të kreh flokët), po çit një letër (po gris një letër), po çit një sherr (po ndaj një zënkë), në arça u do flas (nëse vi unë do flasim), ishnë pa ngrënë e kishnë ū (ishin pa ngrënë e kishin uri), bleva miell të grinjë (bleva miell gruri), e dau punën me të tjerët (e ndau punën me të tjerët)*.

Përdoren shumë fjalë të prejardhura, si kompozita mbiemërore: *fustanpalarë, mandilezezë, kukëpështjellë, truçkulur, zemërshtog, bithëmëshkopash, vandaqemadh, faqefurrash, veshëverdhe, veshëprerë, bubuzhinë, qaramidhe, trastamadh, mëndjehollë, surratstrufe, kokëxhorre, rrefëgore, gjuhënëpërkë, poturebran, cipëplatur, kukungjeçi, mutvështuar, kukëkadhe, kukëshqope, kukëká, leshlëshuar, vulëhumbur, mëndekacorr, kukërrugje, turispec*.

Përdoren fjalë të përngjitura: *këndiparë, modrua, miretumirë, nureshtat, metabashkë*.

Përdoren kompozita ndajfoljore: *çikapika, kotefat, rrotull e kapotull*.

Përdoren fjalë të tjera si: *njëra* (deri): *u mbush njëra* në griqë (u mbush deri në grykë), *fëjej* (faj): *pa faj fëjier* (pa pasur asnjë faj), *pëjes* (pyes): *t'u pëjesë e ta pëjini* (t'u pyesë a ta pyetni), *shtrojë* (shtresë): *kam shtrojenë* time (kam shtratin tim).

E folura kudothsiote ka n  p rdorim fjal  nga greqishtja, turqishtja, sllavishtja e latinishtja. T  p rdorura n  koh  k to fjal  jan  pjes  e ligj rimit t  p rditsh m.

Nga greqishtja: *orm s, to dhjo, qerdh s, parapon , anap dhjar, anap dha, ksif s, dh ks, ep men, allon r, kal dhe, Pajoh ar, moll ois, kser ledh, ks r , kserik , sorol dh, katafiq, sor , kuk c , Kosm r, mavr koqe, provesht , kran , p ca, mesar qe, v mlo, srtongjillo, Vasill q, stam ti, adhj s, afendiko, af on, af ndos, anam sa, ajodhima, skolariqio, argali, allos j, bit s, bocop ll , bodile,  kromol ps, kr ma, dhask l, fa , dioq z , dajand s, damll s, dhek ti, dhioli, dhiks re, dhj f, dhjakon r, dhok n, eparq , eksiq, epitr p, farmak sur, farm ka, farfur , fell k , fir s, fot , fa , gr m , gost , gjiton, hajdh , horn , ilak , jahni, jatri, jatr ua, jerokomio, kab t, kallav cazi, kallam , kasand s, kapetan, karf s, kat ua, kallogr , koft , k lce, kr shm , kol s, korsh , kutur , kop dh , ksheas m, lav s, left ros, ll t , lemer , leond r, l t rv , lim r, mandile, man r, mast ra, mavr , matrak, moro t , m i, ilak , ner qit, nakat s, noks n, nom , pllock r, pat ks, paran ke, palik ari, path ua, pson s, proshqef ll , pedh ps, pllak si, pedh qi, perdh ka, pokt s, platoh q, pot s, poft s, qot , skoli, send n, sirm , stratigo, strati t, str m , sin r , sinda , s ja, ujd s, z har, zograis, zil r, zeh r, zoi, z , zgr ps, vivlin , vrok llak, falidho, poganique, protoj n, pap l, sak q, str m nx , sulin , shq dhjo, korojdhi, kadhron, gramaq llo, mallafr qi, mudh stra, vr zi, llavurdis, mellan, strungulis, qio, litrjo, ll sp , kallogr nja, nasqir s, pedh ps, gall na, kataf r, trap lla, thio, rizog ll , hom , g lla, cek re, ck rt , ckordhal , cit s. ckapet sur, apoth q, arg t, arg lo.*

Nga latinishtja jan  emra vendesh si: *Farf ra, Vila, Kan l, K l , Kast l.*

Nga turqishtja: *K xhaku, Kor oka, Kas m, jes r, k ra, sufr n, lez t, penxh re, doll p, dush k, sihariq, buraz r, b rek, q p, qim r, mushteri, gjusll ke, dumb k, buh r,  ib k, xhezv , tenxh re, teps , q lim, xhar pe.*

Nga sllavishtja: *Borrishta, Ok lez , K shta, Lajv daj, D sha, Kongjip  ul, Baxh vik, Gradisht , D b r, Zhupalie, Stog , K   (M rti), bl nj , llaz n , br n, mbr turk, drev nic .*

SHPREHJE T  KUDH SIT

Kudh si ka pasuri leksikore t  ve anta.  sht  men uria e brezave, q  i kan  krijuar e shprehur. Jan  vler , qytet rim, kultur  t  shprehuri e respekt p r veten dhe t  tjer t. U mblodh n n  vite, ashtu si jan  th n  duke ruajtur identitetin e m vet sin . U ve uan n  biseda t  zakonshme a t  shkujdesura, por dhe n  k ng , vaje e bejte. Kjo trash gimi kulturore u takon t  gjith ve, atyre q  i ruajt n dhe i p rdorin akoma. Gjuha dhe mendimi vjen me forc  shpreh se, ashtu si   sht  p rdorur n   aste g zimi a hidh rimi.  sht  vet  njeriu kudh siot me filozofin  e tij n  p rshtatje me jet n, g zimet, brengat e shqet simet dhe k to shprehje i gjejm  si t  p rdorshme m  shum  n  Kudh s. Sa vler  ka kjo e folme, ky mendim, kjo men uri!

Aferum ç'e hoqi nderi (u nderua).
Ai ka hundë (egoist).
Ai rruan pleshtin (kursimtar).
Ai s'dij ç'ish plumbi (trim).
Arat i jep me të tretë (tri pjesë).
Bëhet si laharjep (i zhveshur).
Bëj be e rrufe (betohe).
Bëra kilë strufullare (në strufe).
Bëri këmbë ditën e vitit (i pari).
Burrë të mbajti qiteti (nuk erdhe).
Ç't'u qep e t'u bë fërrë (të përndjek).
Çark ia bënë shtëpinë (e rrethuan).
Çikëre haberet vijnë (me shpejtësi).

Deshe të shtojë hirate (i pangopur).
Dirë më të dirë (mëngjes).
Djalit i dhanë uratë (e bekuan).
Do hedh kongjulen (do varem).
Do ta marr ta psoj manare (të urtë).

Duket nga takëmi (nga veshja).
E bën fët e fët (shpejt).

E bënë leco (e telendisën).
E bëri faqen si bitha e kuisë (e nxiu).

E bëri marmarë (e shndriti).
E bëri qullupaçe (brumë).
E bëri rreth me gurë (gardh).
E bëri safraqesh (ia hodhi).
E bleva, se ha lerën (nuk duket e ndotur).
E çkre si qëni gurin (s'i ndahet).
E do dita (do dhënë).
E gjykoi xhelalëmi (populli).

E hëngri me gali (me lajka).
E hëngri sëmunda (u tret).

E hodhi me tesqegjul (pa menduar).
E hodhi në bela (në hasmëri).
E hodhi stokufo (vetëm rri).
E ka barkun hambar (zemërgjerë).

E ka burbon me vete (të keqen).
E ka djalë më dorë (të sigurt).
E ka dorën zigj (i saktë).
E ka gojën kinino (të hidhur).
E ka grikën honestër (pus).
E ka jaradisë Zoti (e bekoi).
E ka kokën si boçkë (të vogël).
E ka kokën si çetur (pa formë).
E ka kokën si gorricë (të vogël).
E ka kokën si shqebon (kokëbosh).
E ka mënden në këmbë (i vonuar).
E ka mënden në kokë (i arsyetuar).

E ka në këmbë të qënit (i papërfillur).
E ka qupin adhjo (kokëbosh).
E ka të ligën brënda (vuan shumë).

E këput mëllënë (llupës).
E kërreve po se mole (s'arrite).
E lanë në një përrua (vetëm).
E lidhë me zengji (me hekura).
E mba bisht e brijthi (avaz).
E mbajta në pëqi (në prehër).
E mësoi zullumi (e keqja).

E morën ëxhga-bëxhga (me forcë).
E ndezi fiti-fesat (sherr).
E piks ujin e bën djathë (mashtro).
E prunë më shulë (i vdekur).
E pruri buçi (rasti).

E qëlloi me fufa (gurë).
E qëroi pjatën (e përllau).
E rritur me kulaç të situr (e ushqyer mirë).
E shitën ca të pabrekë (hajdutëri).
E vuri kokën më dekijë (u merakos).
E zu gjarpërusheja (e helmoi).

E zunë gafil (pa pandehur).
E zuri cukthi (e pickoi).
E zuri hasha (s'tregoi).

Ecën hapashalazi (këmbëhapur).

Ecën lugje-lugje (me hapa).

Ecën si bullar (ngadalë).

Epimeni në të tij (këmbënguli).

Erdhi drëra mbrëma-mbrëma (në darkë).

Erdhi kallavucazi (ngarkuar).

Është bakulli vetë (i pazoti).

Është bërë busmë (trung).

Është bërë si i pari i tire (xhind).

Është bërë ta çaç me shërrë (i shëndoshë).

Është bërëtok (punëtor).

Është buhar (i trashë).

Është cinxurr nga mëndja (mëndjehhtë).

Është dorëçpuar (prishës).

Është fjalë lashtërishte (e vjetër).

Është flakë dufeku (gjaknxehhtë).

Është gjarpër e të ha (i rrezikshëm)

Është gjarpër në gji (të helmon).

Është i këmbier (i ndërruar).

Është i llamikartur (i përpunuar).

Është i ndërkyer (i çmendur).

Është i tojbetisur (i mallkuar).

Është karkacul nga mëndja (i papjekur).

Është kashtë më këmbë (i pafuqishëm).

Është këmbë e dorë jave (përtace).

Është këmbë ndë bithe (e shkurtër).

Është kilë nga kulaçi (njëlloj).

Është kokëkrënde (e pakrehur).

Është kokëshqope (i pagdhendur).

Është koraq i qelbur (hajdut).

Është lesh çakërre (përpjetë).

Është mëndekacorr (i lehtë).

Është nur e shtat (i pashëm).

Është qosëvënd (prodhon, sjell).

Është qullash fare (i plogët).

Është si bukë e mbrume (i fryrë).

Është si glluç (i butë).

Është si kokoshgollos (i ngrehosur).

Është si majë gomarit (i turpëruar).

Është si në bark të kaut (ngrohtë).
Është si top bubuzhine (i rumbullakosur).
Është si trasta më degë (i pasigurt).
Është vesh më dhé (dëgjon).
Është xhudam (i humbur).
Është zëmërbehar (i paqtë).
Është zëmërshog (i butë).
Është zog i zografisur (i pikturuar).
Flet shutru-kutru (pa menduar).
Folë e folë, u vllapsa (u rëndova).
Frin mbarsëlisja (pranverë).

Fshat i paudhë (shejtan).
Futi kukën ndë kufar (e uli).

Gjarpëri, që na ka zënë (e keqja).
Gjemitë formojnë tëndë (hije).
Gjeti manxhë (mall).
Gjithë i bënin temena (e nderonin).
Ha e friju e del e çfriju (i papërgjegjshëm).
Ha pa shkop (pa masë).

Ha sikur ka çëmërrin (i pangopur).
Heq më zëmër (i sëmurë).
Hidh e piq m'ata palcarë (të njomë).
Hiquni, o të paudhë (largohuni).

Hoqi shumë taksirate (i munduar).
I bekuar si ulli (i vlefshëm).
I bën turinjtë si bithë pule (buzëvarur).
I bëri arat gardh (i thuri).
I bëri isharet (shenjë).

I bëri kokën fllaçkë (e çau).
I bëri lëmishte (i coptoi).
I bëri puna beli (i duket).
I bëri sostri (i shoi, i shtriu).
I bëri stravilarë (i rrëzoi, i vrau).

I bëri tertipnë (planin).
I doli bitha katër kut (u mundua).
I erdhi allakten (papritur).
I hapi zorrët (e shpoi).

I hëngrëm dasmën të dekurit (e përcollëm).

I hipi breshkës e vate (ngadalë).

I hodhi ujë zjarrit (e shoi).

I hoqi destemelin (shaminë).

I ka bërë kokën (e lindi).

I ka duart në miell (fshehurazi).

I ka liruar burgjitë (vidat).

I ka trutë rrathë-rrathë (bosh).

I kanë mbetur kokallet (i dobësuar).

I kërreu mellanin (bojën).

I la stromën thatë (u largua).

I lanë vatrën thatë (pa fëmijë).

I nxorra dhëntë me vulë (mirë).

I paudhi të ka prerë (shejtani).

I polli mushka (fati).

I ra bisha (ujku).

I rëndon koka në krahë (pa arsyetim).

I rruaçin takëmet (pa respekt).

I thotë si histori (i rrëfen)

I thotë si ndë kartë (rrjedhshëm).

I vunë sinor (kufi).

I vuri bejtet radhë (i radhiti).

I vuri shtatë më radhë (i vrau).

I zunë sytë panë (u verbua).

I zuri kokën marja (u deh).

I zuri mexhitja griken (ryshfeti).

Ike e ia le në derë (e turpërove).

Ikën e shëndetin lanë (u larguan).

Ikën me kohë të mirë (u shmangën).

Ikëni, se s'ua kam ngenë (nuk dëshiroj).

Iku së mirë zëmëre (pa u sëmurë).

Iliveri me fanua (me shkëlqim).

Ishin mizë lisi (pa fund).

Ja dha me vupe (shumicë).

Ja hipi Gjoka Gjikës (e kaloi).

Ja vuri në biná (në themel).
Janë bërë pirosti (tre bashkë).

Jemi dashur si evlatë (si fëmijë).
Jot ëmë e pastë lanenë (mallkimin).
Ka cofur më parë (ka ngordhur).
Ka dalë me ferman (me turp).
Ka hirë i paudhi në mes (djallëzia).
Ka një vatër fëmijë (shumë).

Ka shkelë hijet (xhindet).
Ka zënë fec (egoist, mendjemadh).
Kakën, kabul, kakën (gogol).
Kam lerë ditën e Ajomavrës (të zezë).
Kanë qerdhesur dunjanë (fituan).
Këmbë lepur e gojë qepur (i heshtur).
Kemi një njeri me kokë (të mençur).

Këput gërmule (të papjekura).
Këputi një bisht berra (pjesë).
Kërkon të bijën e mbretit (të paarritshmen).
Kish hije, ku shkeli këmba (bukuri).
Kishte besë e kuvënd (pleqësim).
Kondopërre, rrefëgore, meskalore (e vullshme).
Ku i bëri kuka bam (ku lindi).
Kumbisur derë më derë (afër, mbështetur).

Kur do të heq kapaknë (do të turpëroj).
Lanet ishte ajo ditë (e mallkuar).
Le të hedhë vaj të shkasë (pa vlerë).
Llafoset kata s'ta valta (pa adresë).
Llomie në allonar (copë-copë).
M'u pofitis pa kuptuar (pa të drejtë).
M'u pofitise mua (më shqetëson).
M'u si qisha pa kambanë (pa drejtim).
Ma bën kokën si rrugje (kazan).
Ma bëri gjakun ujë (më trembi).
Ma kërreu nga barku (e largoi).
Ma nxori nga barku (u mërzita).
Ma zuri në grykë (ma përfoli).
Mbuloi vëndin mavria (e zeza).
Më bëhet si shëngjallo (i shëmtuar).

Më bëhet si vrokollak (pa formë).
Më erdhi shpirti ndër dhëmbë (s' durova).

Më farmakose të zinë (më helmova).
Më je bërë si kanosjar (çmues).

Më kataferi (bindi).
Me nishan nga perëndia (i shenjuar).
Më pedheps (mundon).
Më shteg e tej (kaloi).
Më vrave e ma le plumbin brënda (dhembje).
Më vuri lesh më zëmëre (maraz).
Më zuri sata (u pështjellova)

Merr një thua djathë (pak).
Mes me pulla (me fishekë).

Mo jeshë burrë doveti (i njohur).
Mo qe suferinë e erë (e shpejtë).
Mo të vrau kokëkau (kokëmadhi).

Mori agrafat (grada).
Mori gallona të ergjënda (spaleta).
Mos e pupurr (mos fol).

Mua m'u ngarkua barrë (u fajësova).
Na kërkon baba e mëmë (na mundon).
Na mba tre sahat më këmbë (na mundon).
Na pruri katastrofi (shkatërrim).
Na vjen lugje-lugje (me vrap).
Ndë mbar të kripë, mbari (fati).
Në litar të gjithë vemi (vdesin).

Në Stamboll i vate nami (u shpërnda).
Nuk ka koqe në griqë (s'mban fjalë).
Nuk më shkoi poshtë (më ngeci).
Pa është rrefëgor (dembel).
Pa faj fëjier (i pafajshëm).
Pa, ju ngre ujët (u acarua).

Paratë janë si pleshtat (largohen).
Perëndia të ngrë, perëndia të ul (kujdes).
Përmjer majë gjëmbit (e mban lart).

Pesë miza hëngri belevi (i pavëmendshëm).

Punojnë kokëxathurit (të pambrojtur).

Punon me inat e pa takat (pa fuqi).

Qe lavosur ndë kukë (i plagosur).

Qe lavosur në kukë (i plagosur).

Qe mirë e tumirë (pa sëmurë).

Që zure dyfek me gra (luftove).

Qeni ngordh e ai s'ngordh (i paepur).

Qepa nën shtrat, buka në sergjënd (merri vetë).

Ra më buzë (u rrëzua).

Rri dhokan ngrehur (në pritje).

Rri kumbisur i golëmi (mbështetur).

Rri në zërminjë (në diell).

Rri si buba e dhrisë (e vrenjtur).

Rri si maçi pili sufranit (i gatshëm).

Rri si më gjëmbe (pa qetësi).

Rroi treqind shalë e treqind dunja (jetëgjatë).

S'bëjnë kukul kurrë (shpërdorues).

S'bën suval (pa radhë).

S'i dëgjon kadhja (kokëfortë).

S'i dheksën të ligat kurrë (s'i pranojnë).

S'ka tri në të therme (mendjehetë).

S'kërren pulën nga koshti (i pazoti).

S'më hyn në patë (s'kuptoj).

S'më zuri dhëmbi (s'fitova).

S'pyete se kish taborrë (nuk u frikësove).

S'të jep as thonjë bufi (koprac).

S'ua kishin na me na (s'e llogaritnin).

Se e rrita me hajdhi (me përkëdhelje).

Se qe rritur në mulli (i ngrënë).

Se u hodh si ezhdërha (si kuçedër).

Ikën e shëndetin lanë (u larguan).

Sheh avllinë, mëson shtëpinë (rregull).

Shiu i beharit si p...t e gomarit (me ndërprerje).

Shkruan kaçapuça (pa rregull).

Shullëhet si bullar (shtrihet).

Si breshër me kërcëllimë (i zhurmshëm).

Si guri më të përpjetë (nuk ecën).
Si i zoti dhe suvaja (e dobët).
Si kaçup u rrukunis (i fryrë).
Si mësalla me dy faqe (i paqëndrueshëm).
Si rrufe me suferinë (katastrofë).
I vuri shtatë më radhë (i vrau).

Si Sotire Verba zorrët (qorrazi).
Si zogë nën cilonë (i trembur).

Sikur do vete krushk (i veshur).
Sikur ka ngrënë bithë cinxurri (llafazan).
Sikur kam burbon (të ligën).
Sikur më zuri në koshtëra (më turpëroi).
Sikur qe xhinde me erë (e shpejtë).
Sorkadhi që shkel më thua (i shkathët).
Vuri dulbinë në si (i shikoi).

T'u qepnë e t'u bënë ferrë (të përdoqën).
Ta rraç i merr gjynanë (i dobët).
Të arça e mos më arç (s'të pres).
Të dërgova kallauzë (lajmësin).
Të madh e bëri timinë (nderin).
Të madh e vuri xhizenë (taksën e familjes).
Të madh i bënë timinë (e respektuan).
Të mbeti fjesa më dorë (pastërti).
Të muarrë djeltë jesirë (robër).
Trim i mirë e bithë gurit (i zoti).
Tutje-tëhu si përpica (e lëvizshme).
U bë lemendo (ndryshoi).
U bë lllomie (gurë të vegjël).

U bë më cingal (po rrëzohet).
U bë me hije (u tremb).
U bë për lumë e det (u telendis).
U bë se ma deshi ënda (qejfi).
U bë si biçak i gjetur (pa funksion).

U bë si ma deshi ënda (si dëshiroja).
U bë si mish i plasjes (u qelb).
U bë si qetë e vjetër (pa gjallëri).
U bë si u bë, mo jemi gjak e gjë (të afërm).
U bë vrer (u helmua).

U bënë gardh (u bashkuan).
U bënë push e pëndë (u shpërndanë).
U bëre korbë e natë (u nxive).

U çkapëjie në gas (u gajas).
U çkre fare (u lëshua).
U çkul gazit (qeshi).
U çkuli barkun (vollën).
U dolla djelli leu (ndriçoi).
U e zeza do zë vajnë (do vajtoj).
U erdhi sosmoi (tërmeti).
U është shuar rodina (fara, soji).
U kthye si buka më që (përmbys).
U madh e zuri fec (egoist).
U mbëlodhë e bënë masë (vendosën).

U mblodh më jatak (në shtëpi).
U në mal e ti në gurrë (të malluar).
U në varre, ju në lisa (pas meje).
U ngop me lugë të mbrazur (bosh).
U poq në një hundëlesh (i ngeci).

U poq te piqen bukët (u torturua).
U tha e u bë dru (u dobësua).
U thau zorrët gruas e fëmijëve (s'i ushqeu).
U treguan dhëmbët (forcën).
U tret e u bë pulë (mbarove).

U zbardhën qeprët (u gëzuan).
Ustai pështyn çokun (mallkon).

Vardha, vingo (pa rregull).
Vate çoç kohë (mesnatë).
Vetë kur e ndezi sherrë (e filloi).
Vjen si e mbodhisur (shtatzënë).
Vret manovët e dovetit (ushtarët turq).

Vu dulbinë në si (shikoi).
Vuri kujën që menatë (vajin).

Vuri lesh më zëmërë (maraz).
Xhinde mushka, pela vetë (e fortë).

*Zuri dregëz (u mbulua).
Zuri llafin në kuvënd (fjalën).*

URIME

*Të rroç sa Guri në Shkalla!
Rrofsh e të jaradistë Zoti!
T'u bëfshin ditët vjet!
Të vemi mirë e të kthehemi mirë!
Të ligat i marrtë i ligu!
Shpëtona o Zot nga kjo e keqe!
E griç bardhë me babanë!
Djalë të rruat koka!
U shtofshi si do Zoti!*

MALLKIME

Bota emocionale e banorëve të Kudhësit shfaqet edhe te mallkimet. Marrëdhëniet familjare, shoqërore, njerëzore dhe sistemi i edukimit kanë qenë të hapura, por jo gjithmonë gjërat shkojnë mbarë. E nëse kjo ndodh fjala rëndon, shprehja vret dhe toni të shkëlqon nga vendi. Duket sikur natyra deformohet, shpirti nxihet, se “gjuha kocka s’ka, por kocka thyen!”

Shprehjet e mallkimit në Kudhës i gjen të rënduara nga pakënaqësia, konflikti, sjellja e prishja e rregullave. Nga mallkimi artikullohet dhimbja dhe mjedisi tronditet. Inati, mëria, urrejtja, por edhe “thyerja” e shpirtit njerëzor janë të dukshme. Ka vetëm plagë, që duket se i mjekon vetëm trishtimi.

Mbase shprehjet e mallkimit janë të mbartura nga shekujt, por pikëllimi arrin deri në mohimin e jetës. Duket sikur mallkimi sjell sëmundje të rënda si: malina, kollpua, tënja, garbuni, plasja; dëmin e pjesëve të trupit si, p. sh, buza, zverku, sytë, gryka e duart. Kërkohet forma e shuarjes së jetës, vdekja dhe në plan të parë dalin mandata, zia e gjithçka bëhet natë. U drejtohen objekteve të kultit si Panokratori, Krorëza, Kakomeja, emrave të shenjtoreve e më tej ftojnë për hakmarrje xhindet, të paudhin, kandilen. Nuk mungon prania e shpendëve si kukumjaçka, bufi e shqipegabati. Mallkimi është përdorur dendur nga gratë, por rrallë edhe nga burrat. Kanë besuar, se mallkimi apo nëma e babait është shumë e rëndë.

*Të marrtë i paudhi!
Të daltë plasja!
Të qëlloftë nga Panokratori!
Të hëngërt malina!
Të vraftë pa rë!
Të marrçin xhindet!*

Mos gëzofsh!
Mos arç (mos u difç) pëllua!
Të hëngçin shqipegabab!
Të artë mandata!
Të rëntë kollpua!
Të zëntë buba!
Mos të dashtë Ai, që të dha!
Të zëntë buba me dy kukë!
U thafsh e u bëfsh kucurë!
Të ndënjtë më të fira!
Dalç me brij!
Dalç me brij e me gadraveshtë!
T'u shoftë shënja!
Të daltë në griqë!
U shkrofsh në qishë e në xhami!
Të hiftë në bark!
Marrç mullijtë e pa ujë!
Zënç xerkun!
Të hëngërt lia!
Thefsh xerkun!
Të dalçin sitë!
U këndoftë kukumjaçia!
Vafsh Krorëzë!
Vafsh kallogre në manastirë!
Vafsh në Kakome!
Mos t'u heqtë e liga nga dera!
Të marrtë pas koke!
Të hëngërt tënja e qëne!
Mos i vufsh di mbi di!
Të hedhçin kashtë fshati!
Të zëntë pickurri!
Vafsh e mos ardhç!
Të arça e mos të gjeça!
Qofsh në lëkurë tënde!
T'u sostë kandilja!
U bëfsh m... e të hëngçin pulat!
Mos mbetë as djalë, as koce!
Xerkun si xerkovaçi, katër këmbë si kërraçi!
Të zëntë cukthi!
Të prufshim më shulë!
Të hiftë e të këndoftë!
Të daltë në gushë!

Të dhënçin m... dhe e quajç bukë!
Mos vënç fëmijë më duar!
Të hiftë në bark!
Të vraftë zubuani!
Thefsh këmbën më portë!
Të hëngërt garbuni!
Të marrtë atë, që të lidhi kërthizën!
Dis e qofsh ndëjjerë, se të keshë urryerë!
Të daltë në koqe të grikës!
Të marrtë kadhen!
Të daltë mallafraqi!
Mbeç korbë e natë!
Të zëntë buba me di kukë!
Të hiftë polomiu!
Vafsh në të shumë!

FJALORTH I KUDHËS PERIVOLIT

Pasuri shprehëse janë fjalët e përdorura në komunikimin e përditshëm, por dhe në vargjet e bejtet e vjershëtorëve kudhësiotë. Brenda të folmes së krahinës ngjajnë të mëvetësishme dhe shumë herë kanë interes studimor. Të mbledhura në vite, zgjodhëm një fjalorth, ku duket harmonia e përdorimit. Kuptimi i fjalëve është përshtatur sipas përvojës të studiuesve dhe të “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”.

A

adét -i *m.* zakon.

adhjás *kal.* boshatis.

afándos *ndajf.* papritur.

afendikó -i *m.* zotëri, pasanik.

afión -i *m.* i zverdhur.

agáv/e -ja *f.* bimë me gjemba.

ajázm/ë -a *f.* ujë i bekuar.

ajodhim/ë -a *f.* pjesë e kishës ortodokse.

allonár-i *m.* korrik.

allósoi *mb.* i tjetërsuar.

anázi *ndajf.* u kaloi anash.

anámesa *parafj.* në mes, ndërmjet, midis.

anangás *kal.* ngacmoj, trazoj.

anapódha *ndajf.* ndryshe.

anapódhjar *mb.* i prapë.
andíe *parafj.* deri; ndenji deri vonë.
apothíq -i *m.* depo. *I vura në apothiq.*
argalí -a *f.* tezgjah druri.
argat -i *m.* punëtor. *Vura një argat në arë.*
árgjilo *f.* baltë.
atej (ë) *ndajf.* andej.
atí *ndajf.* aty.

B

bobót/ë -a *f.* grurë i bluar; kofto.
bace -ja *f.* pëllëmbë. *I dha një bace.*
bájrak -u *m.* flamur.
bakëre *mb.* kusi, tepsi prej bakri.
bákull -i *m.* trup i shëndoshë, i fortë.
baláco- ua *mb.* palaço.
balçé -ja *f.* baçe.
balín/ë -a *f.* sfera që luajnë fëmijët.
bandier/ë -a *f.* tabaka.
bárb/ë-a *m.* vëllai i nënës apo babait.
barbác -i *m.* arbëresh i Greqisë.
bardhák -u *m.* gotë e madhe uji.
barkamút/e -ja *f.* dardhë e madhe.
barkgjërë *mb.* që mban shumë gjëra.
basmat/á -ja *f.* vendim, shkresë.
batáll *ndajf.* hapur.
belí *ndajf.* që duket; i bëri puna beli.
beozúr *ndajf.* e zgjatën, e përfolën.
berónj/ë a *f.* dhi që nuk pjell, shterpë.
berr-i *m.* bagëti e imët; mish berri.
besëqën *mb.* i pabesë.
béck/ë a *f.* me bark të madh.
bërëtok *ndajf.* i zoti, njeri që mbledh.
bgá *pasth.* bah.
bífk/ë -a *f.* lloj lakre.
bimbásh -i *m.* major.
biná -ja *f.* themelet e banesës.
birko *ndajf.* bukur.

bishtók -u *m.* mëz njëvjeçar me bisht.
bishtra *mb.* të mbetura, të shpërndara.
bitís *kal.* mbroj, kryej, i jap fund.
bithaprápazi *ndajf.* praptas.
bóbël -a *f.* kërmill.
boçkár *mb.* (fik) i papjekur.
bocopúll/ë -a *f.* shishe e vogël.
bolori *ndajf.* me turp.
bonják -u *m.* jetim, pa nënë e baba.
bodíl/e -ja *f.* shishe qelqi.
bránë *ndajf.* zvarrë; rrëshqanthi.
bráshnj/ë -a *f.* opingë e vjetër.
brerím/ë -a *f.* vend i pjerrët.
brimádh/e -ja *f.* dhi me brirë të mëdhenj.
bërrúc -i *m.* gunë, shark.
búb/ë -a *f.* gjarpër, nepërkë.
bubuzhín/ë -a *f.* insekt që ecën e fluturon.
buçkovjásur (i) *mb.* i hequr, i dobësuar.
buhávitur (i) *mb.* i ënjtur.
buhóv -i *m.* pluhur, tym.
bujashk/ë -a *f.* copë druri me lëvore.
bujurd/í -a *f.* urdhër.
bukëfiq/e -ia *f.* bukë me fiq të bluar.
bukëthepé -ia *f.* lloj lakre për ushqim.
bukurán/e *mb.* i, e bukur.
bullár -i *m.* gjarpër johelmues, i ngathët.
bunác/ë -a *f.* ujë i qetë pa dallgë.
buzémúshkë *mb.* që i ka buzët të gjera.
buzévíç *mb.* që i ka buzët të gjera, ngjyrë kafe.
búsmë *mb.* kopaç i nxirë.

C

camb/úa -oi *m.* kalli misri.
cangádh/e -ia *f.* dele a dhi pa qengj e kec.
cenós *jokal.* e bëj me cen, gjymtoj.
cekúr/e -ja *f.* sopatë. *Preva me cekure.*
cénój *kal.* e prek rëndë.
cërm/ë -a *f.* sëmundje e kyçeve, cerma.

cilón -i *m.* fustan. *fig.* Si zogu nën cilon.
cimbídh -i *m.* mashë për të marrë prush.
cimbís *kal.* ha; marr nga pak.
cimbísur (i, e) *mb.* i lehtë në mendim.
cimbël -a *f.* ashkël. *Futa një cimbël.*
cíngal *ndaif.* gati për të rënë.
cingarídh/e -ia *f.* copë e vogël në tigan.
cingórr -i *m.* i ftohtë i madh; acar.
cingrís *kal.* trazoj dikë ose diçka. *Cingris urët.*
cínxurr -i *m.* gjinkallë.
cipál -i *m.* pjesë e hollë druri.
cipédálë *mb.* i paturp.
cít/ë -a *f.* pykë, copë hekuri për të çarë.
citós *kal.* ngjesh; i fryj dikujt në vesh.
cítur (i, e) *mb.* I shtyrë nga dikush me qëllim.
ckapetísur (i) *mb.* I çmendur.
ckordhala -t *f.* patate me hudhra dhe vaj ulliri.
ckortë -a *f.* pyll i dendur.
coják -u *m.* thikë e vogël xhepi.
cpithár -i *m.* gropë në gur me ujë shiu.
cpórdhës -i *m.* shpirti. *I doli cpordhësi.*
cúkth -i *m.* akrep; cuqthe.
cul/ë -a *f.* lloj fyelli.
cullúpurdhjar *mb.* ngatërrestar.
currufjás/em *jokal.* matufepsem.
currufjásur (i) *mb.* i matufepsur.

Ç

çakallósem *vetv.* bëhem si i tërbuar.
çakërréps *kal.* më shkojnë sytë anash.
çakí -a *f.* thikë e vogël. *Kam çaki xhepi.*
çallt/í -a *f.* çati. *I hoqën çalltinë.*
çalltís *jokal.* përpiqem; ndihmoj dikë.
çelitur (i, e) *mb.* i gjallëruar në jetë.
çelník/ë -a *m.* pronar i tufave të bagëtime.
çëmërr -i *m.* pangopësi. *I ka hyrë çëmërri.*
çep/é -ja *f.* flokë të gjata. *I prenë çepenë.*
çepél/e,-ja *f.* varg me fiq të thatë.

çepërk/ë -a f. shtëpi ose kasolle me plaçka.
çerép -i m. enë balte si tepsi. *Bukë çerepi.*
çét/ë -a f. grup njerëzish. *Çeta e Bregut.*
çetúr -i m. enë e drunjtë; kupë me bisht.
çfrin jokal. shfryn, përhapet. *Fjala çfrii në fshat.*
çinxhërrin kal. hap sytë.
çit kal. shqit, kreh flokët. *Çita flokët me krëhër.*
çit kal. gris një rrobë a një letër.
çitës -i m. krehër me dhëmbë të hapur.
çkapëjej kal. hap me forcë. *Çkapëjej derën.*
çkors/ë -a f. shkorsë; mbulesë prej leshi.
çkromoléps kal. pastroj një vend të ndotur.
çkul kal. i lëviz bagëtitë. *Çkul qepë.*
çminja mb. tallje, ironi. *Është gjithë çminja.*
çmés -i m. ai që cakton vlerën e dëmit.
çoçomejthi ndajf. *U hodh çoçomejthi.*
çók -u m. lloj çekani për të ngulur gozhdë.
çokál/e -ia f. zile a këmborë e vogël.
çokan/e -ia f. këmborë e vogël e shtypur.
çpikurrim -i m. Spec djegës.
çpip kal. shpif; merret me fjalë.
çpipet vetv. fig. shfaqet, shkaktohet. *M'u çpip sëmundja.*

çurud/í -a f. habi. *Kjo ishte çurudi.*
çuruk mb. që ka një cen; i gjymtuar.

D

dáck/ë -a f. pëllëmbë. *I feksi një dackë.*
dáj kal. ndaj. *Daj gjellën.*
dajandís jokal. duroj; qëndroj fort.
dále pasth. prit. *Dale me ngadale.*
dalurë (i) mb. i shëtitur. *Është i dalurë.*
dámllós jokal. paralizoj. *U damllos në tru.*
danám-e f. anije. *Erdhi me danam nga deti.*
dedé mb. i urtë, i padjallëzuar. *Njeri dede.*
deftér -i m. regjistër. *E shënova në defter.*
déj ndajf. më vonë. *Do nisemi dej.*
dékëj/ë -a f. vdekje. *Vemi në dekëjë.*

dés *jokal.* vdes. *Kish dekur i ati.*
dékurë (i) *mb.* i vdekur. *Erdhi i dekurë.*
derëbábe *mb.* shtëpia e babait.
derëbárdhë *mb.* i uruar.
derëzí *mb.* që ka pasur shumë fatkeqësi; i mjerë.
destémel -i *m.* shami koke grash.
déndet *jokal.* ngopet. *Hëngri sa u dend.*
dërkúj *kal.* ha darkë. *Do dërkuj më vonë.*
dërm/ë -a *f.* goditje. *I dha dërmën.*
dërrudhë *mb.* kaçurrele. *Lesh dërrudhë.*
díar/e -ja *f.* xhezve; masë për dy kafe.
dioqéz/ë -a *f.* format kishtar.
dirë (të) *as.* të gdhirë, agim. *Foli më të dirë.*
dirék -u *m.* dru i gjatë, i drejtë në anije.
ditëgjatë *mb.* jetëgjatë.
djéltë *m.sh.* djemtë. *Janë djeltë e Bregut.*
dójtë (i) *mb.* i imët. *Është i dojtë.*
dosëbal/ë -a *f.* baldosë. *U bë si dosëbalë.*
dovlét -i *m.* shteti. *I tregoi gjoksin dovletit.*
drág/ua -oi *m.* figurë mitologjike, kuçedër.
dreqësi -a *f.* djallëzi. *Ka dreqësi.*
duállë *kal.* dolën. *Thanë duallë Himarë.*
duduvínë *mb.* e shëndoshë. *Si duduvinë.*
dumbék -u *m.* dybek.
dumbíck/ë -a *f.* dru. *Shkop me gunga.*
dunjá -ja *f.* botë. *Mori vesh dunjaja.*
dushmán -i *m.* armik.
dufék -u *m.* dyfek. *Zure dufek me gra.*

DH

dhaskál -i *m.* mësues.
dhát (u) *jokal.* u dorëzua.
dhekát -i *m.* e dhjeta; lloj takse.
dhekatár -i *m.* mbledhës i së dhjetës.
dheks *jokal.* pranoj, pëlqej.
dhëmbeç *mb.* i ka dhëmbët të rrallë.
dhëmbërárë *mb.* që i kanë rënë dhëmbët.
dhën -të *f.sh.* dhen.

dhënár -i m. ai që ruan dhëntë.
dhiár -i m. ai që ruan dhitë.
dhíkser/e -ia f. enë balte për djathë, ullinj.
dhiolí -a f. violinë, muzikë.
dhjáf -i m. squfur. *Spërkata me dhjaf.*
dhjakonár -i m. lypsar.
dhjávas kal. lexoj.
dhogë -a f. dërrasë.
dhokán -i m. çark për të kapur minjtë.
dhrí -a f. hardhi.
dhurëti -a f. dhuratë. *Dhurëti të nuses.*

E

eksíq ndajf. mangët. *E peshoi eksiq.*
eparqí -a f. rreth, periferi.
epimen jokal. këmbëngul. *Epimen në të tijën.*
epitróp m. kujdestar, administrator i kishës.
érëza -t f.sh. bimë; majdanoz, kopër, rigon.
erriú jokal. erdhi. *Nga griké e malit erriu.*
értim jokal. erdhëm. *Se ertim me parinë.*
érz -i m. sedër, nder. *I mori erzin!*
éthe -ja f. temperaturë e të dridhura.
evlát -i m. fëmijë. *Jemi dashur si evlatë.*
ezhdërha -ja f. figurë e besimit popullor që ngjan si kuçedër.

Ë

ëmt/ë -a f. motra e babait. *Rri te e ëmta.*

F

faí -ja f. gjellë. *Mora fai me vete.*
falídho mb. mendjelehtë.
famullí -a m. familja që i pagëzohet fëmija.
fanúa mb. i shëmtuar.
faqefurrash -i m. kulaç i pjekur në furrë.
farmák -a f. ilaç. *Mora farmaka.*
farmákosur (i) mb. i helmuar.
fëjëj jokal. gaboje. *Pa faj fëjier.*
fellúkë -a f. varkë e vogël e thellë.

fërtún/ë-a f. furtunë.
fickúrr -i m. diarre. *E zuri fickurri.*
fiqír -i m. mendje. *U prish nga fiqiri.*
fakír -i m. i varfër, endacak që rron duke lypur.
firás jokal. tremem.
fitifesát -i m. grindavec, sherrxhi. *Është fitifesat.*
fjés/ë -a f. fshesë. *Fshij me fjesë.*
fláck/ë -a f. enë druri për ujë.
fllaçkë f. e çarë. *I bëri kokën fllaçkë.*
fol -i m. vend ku pula bën vezë.
fólme (e) f. të folurit e një fshati.
fónga ndajf. flakë. *E ndeza fonga.*
fotí -a f. kandile. *Ndezi një foti.*
fqinjësi -a f. të qenit afër
frëngjí -a f. dritare e vogël që shikon jashtë, kamare.
fir/ë -a (e) f. ije. *E goditi në të firë.*
frím/ë -a f. frymë. *U ngopa me frimë.*
frón -i m. ndenjësë e ulët.
frëth -i m. bisht i frutit.
fsák/ë -a f. cfakë, shkurre. *Mblodha fsakë.*
ftísur pjes. ndërtuar. *Ftisur në shkëmb.*
ftom/ë -a f. të ftohur. *Jam me ftomë.*
ftuják -u m. kec dyvjeçar.
fúfë -a f. gur i madh, popël.
fukáce -ja f. bukë e mbrume që ngrihet.
fungáro ndajf. flakë. *U ndez fungaro.*
furqís jokal. mërzit. *U furqisa shumë.*
furrúsh kal. ngarkoj. *Erdhi furrushur.*

G

gáb/ë -a f. shkabë. *E hëngrën gabat.*
garjét -i m. kurajo, guxim.
gajtán mb. e drejtë, fije peri.
gáll/ë -a f. qumësht. *Piu gallë.*
gallón/ë -a f. gradë; spaletë me fije ari.
garbi m. erë e fortë.
garbún -i m. tumor i keq.
gazdaví f. tallje. *I ka gazdavi.*

- gëmíll -i** *m.* kërmill.
gëndé -ja *f.* pjesa e dalë e gushës.
gënúq -i *m.* kec me këmbë të shtrembra.
gërthíj/ë -a *f.* gaforre. *E zuri si gërthijë.*
gërmúle *f.* të trasha. *Këput gërmule.*
gëxhúp *m.* veshje me lëkurë dele.
glláp/ë -a *f.* e thelluar mes gurëve.
glláv/ë -a *f.* shpellë.
gllëqe -t *f.sh.* lëngu që pihet me një të gëlltitur.
gllúc *m.* lakër e egër me kokë si të qepujkës.
gllúp/e -ja *f.* gojë e madhe. *E hodhi në gllupe.*
gocé -ri *m.* rrip toke. *Punova një gocé.*
gófe -ja *f.* eshtër e legenit. *I doli gofja.*
gofkóllo *ndajf.* bosh. *Doli gofkollo.*
gojëhále -ja *f.* njeriu që përdor fjalor të ndyrë.
gojënépërkë *mb.* që nxjerr helm nga goja.
gojëxhárape *mb.* llafazane.
gomárazi *ndajf.* baras. *Luajmë gomarazi.*
gostít *kal.* u jep për të ngrënë e për të pirë.
gramaqello *ndajf.* analfabet.
gramë *f.* mësim. *Nuk mësoi gramë.*
gramáti *f.* shkrime.
grávë *ndajf.* hapur. *E la derën gravë.*
grënjar -i *mb.* sherrxhi. *Është grënjar.*
grínjë (i, e) *mb.* i grunjtë. *Hëngra bukë të grinjë.*
grívë *mb.* ngjyrë gri. *Një mushkë grivë.*
grofólok -u *m.* gropë e vogël.
grósh -i *m.* një e njëqindta e lirës turke.
grúre -t *m.* grurë i zier.
gúduf -i *mb.* i mbushur.
gudúver -i *m.* verore.
gún/ë -a *f.* veshje bariu.
gushtiáre *mb.* dardhë që piqet në gusht.
gushtovjésht/ë -a *f.* shtatori.
guvérn/ë -a *f.* qeveria.

GJ

gja -u *m.* gjah. *Vajta për gja.*

gjarpërúsh/e -ja *f.* femra e gjarprit.
gjegjem *jovepr.* përgjigjem.
gjemí -a *f.* anije. *Gjemitë formojnë tëndë.*
gjindaral -i *m.* gjeneral. *U bë gjindaral.*
gjerb *kal.* ha nga pak me lugë.
gjerdhísh/të -a *f.* shkurre e lartë.
gjë -ri *m.* bagëtia. *Gjëri i gjallë.*
gjesht/ër -ra *f.* shkurre me degë të holla.
gjezdís *jokal.* shëtis. *Gjezdisi botën.*
gjikát/ë -a *f.* gjykata. *Vate në gjikatë.*
gjikim -i *m.* gjykim. *Nuk gjikon mirë.*
gjiritlli -u *m.* banor i Kretës.
gjisht -i *m.* gisht. *Më dhëmb gjishti.*
gjitón -i *m.* fqinj. *Kam dy gjitonë.*
gjitóní -a *f.* fqinjët. *Kam gjitoni të mirë.*
gjudurum -e *mb.* që nuk lëviz nga vendi; ulok.
gjuhëlopátë *mb.* që flet shumë.
gjule -ja *f.* gjyle. *Është kokë gjule.*
gjuvéç -i *m.* gjyveç. *Bëra gjuveç me oriz.*

H

hajdhí -a *f.* përkëdheli. *E mbante me hajdhi.*
hajdúçe *ndajf.* hajdutërisht. *E bëri hajduçe.*
halldúp -i *m.* njeri i trashë nga mendja dhe trupi.
hambár -i *m.* sënduk ku mbanin drithë.
hamurídh/ë -a *f.* insekt që dëmton patatet.
hápsan/ë -a *f.* burg.
hárc/ë -a *f.* vend me gurë të mëdhenj.
hardhj/e -a *f.* hardhucë; zvarranik i vogël.
harr/ë -a *f.* arrë. *Një trastë me harrë.*
harrám *m.* e palejueshme, gjë e ndaluar.
harrónem *jokal.* prishem nga mendtë.
háspos *kal.* shpenzoi, prish.
hatá -ja *f.* fatkeqësi. *U bë hataja.*
hatër -í *m.* hatri. *I ka mbet hatëri.*
hazër *ndajf.* gati, i gatshëm.
háj/ë -a *f.* ushqim. *I mbledhur për kafshët.*
heláq *mb.* i pistë. *Gojë helaq.*

helme -ja *f.* shkurre dekorative.
heqëkéq *mb.* i vojtur. *Është heqëkeq.*
hergjelë *f.* tufë kafshësh që kullosin të lira.
hiráte *f.* prona. *Deshe të shtojë hirate.*
homó *m.* zë, zhurmë që përsëritet.
hón -i *m.* humnerë. *Honi i arrave.*
hónest/ër -ra *f.* grykë e ngushtë e thellë.
hordhí -a *f.* ushtri. *Se të erdhën me hordhi.*
horní -a *f.* hinkë.
hullój *kal.* holloj. *Hulloj petët e byrekut.*
hundal/é,-ja / hundalisht/e -ja *f.* breg që del përpara.
huqimét -i *m.* shteti. *E thirri huqimetí.*
huxhúm *pasth.* sulm.
hyq/ëm -mi *m.* sundim. *Nën hyqëm e urdhër.*

I

ibrét *ndajf.* si mos më keq. *U bë për ibret.*
íkëj *jokal.* iki. *Do ikëj në fshat.*
ilíver -i *m.* ylberi. *Iliveri me fanua.*
ill -i *m.* ylli. *Në saba pa dalë illi.*
ílqe -ja *f.* lloj peme që rritet në Kudhës.
imdát/ë -a *f.* ndihmë.
ipí -a *f.* stivë drush. *Vura drutë ipi.*
ishtë *jokal.* është. *Puna ishtë larg.*
ishtjë -a *f.* fallxhore.
ízë -a *f.* lejë. *Erdhën pa izë.*

J

jahni -a *f.* gjellë me mish dhe qepë.
jáj/o -ua *f.* gjyshe. *Isha te jajua.*
jamullí -a *f.* mbulesë e leshtë, batanije.
jamullék -u *mb.* i papastër.
japí -a *f.* pamje jashtme e dikujt.
jarádis *kal.* krijoj. *E jaradisi Zoti.*
jatruá -oi *m.* mjek. *Më vizitoi jatroi.*
jatagan -i *m.* shpatë.
jatrí -a *f.* mjekim. *Ju bë jatri.*
jenár -i *m.* janari.

jerókomio *m.* pleqërore, azil. *Vate në jerokomio.*

jéshë *jokal.* isha. *Jeshë në kishë.*

jesír *mb. rob.* *T'i morën djeltë jesirë.*

júrush -i *m.* nxitim, vrull.

K

kabádh/ë -a *f.* dhi me qime të përziera.

kabót -i *m.* pëlhurë. *Kabot i ngjyrosur.*

kabúl -i *m.* hije që tremb fëmijët.

kaçapúça *ndajf.* kot më kot.

kacímój *kal.* ngacmoj.

kaçk/ë -a *f.* enë e vogël e prishur.

káčk/ë -a *f.* kupa e gjurit.

kaçup -i *m.* lëkurë për të mbajtur vaj, gjalpë.

kádhe -ja *f.* enë druri për djathë, vaj, verë.

kadhron -i *m.* trarë druri të gdhendur.

kálas *ndajf.* këmbadoras. *Ecën kalas.*

kálce *f.* çorape. *Dy djem me kalce më gjunjë.*

kalésh *mb.* që ka shumë lesh të dendur.

kalídhe -ja *f.* kasolle. *Vate në kalidhe të tij.*

kallakíc *ndajf.* në shpinë. *Vjen si kallakiç.*

kallamé *ndajf.* rrëmuje. *E bëri kallame.*

kalláuz -i *m.* lajmës. *Më dërgove kallauzë.*

kallavréz *mb.* i zi, i palarë. *U bë kallavrez.*

kallavucazi *ndajf.* ngarkuar. *Erdhi kallavucazi.*

kalloçia! *pasth.* kallogre, e shkretë *Bga, kalloçia!*

kallogré -ja *f.* femra që mbyllet në manastir.

kalóre -ja *f.* thupër që godet kalin a mushkën.

kambrí -a *f.* copë e bardhë e fortë.

kámj/e -a *f.* pasuri.

kandís *kal.* i mbush mendjen dikujt.

kapé -ja *f.* grua e zbuluar; grua e përdalë.

kapédán -i *m.* trim, udhëheqës popullor.

kapétanata *f.* këshilli i kapedanëve.

kapist/ër -ra *f.* litar që vendoset në kokën e kafshëve.

kaptój *kal.* kapërcej. *Kaptoi male e fusha.*

kapural -i *m.* oficer në Venedik.

karár -i *m.* vendim. *I dha karar.*

- karáarakoll -i** *m.* vendroje.
- karáv-i** *m.* anije spanjolle me direkë e vela.
- karfós** *kal.* mbërthej. *E karfosa me gozhdë.*
- karkaxhík/ë -a** *f.* enë të vjetra alumini.
- kárt/ë -a** *f.* letër. *I dërgova një kartë.*
- karvéle -ja** *f.* bukë gruri. *Bëra dy karvele.*
- kasabá-ja** *f.* qytet.
- kasandís** *kal.* pasuroj. *Se kasandise për botë.*
- kat/ua -oi** *m.* qilar. *Ullinj e djathë në katua.*
- katandí -a** *f.* pasuri. *Bëri mall e katandi.*
- katimí -a** *f.* qeveri. *Brenda në Paris të shpunë, atje ku ish katimia.*
- katafer** *kal.* bind. *E kataferi.*
- katóq -i** *m.* dhomë përdhese për materiale.
- katërshóre** *mb.* që ka pjellë katër herë.
- kazá -ja** *f.* qendër prefekturë.
- këçëpële -ia** *f.* e vogël. *Është si këçëpële.*
- këllás** *kal.* fut. *Këllas kokën.*
- këlléç -i** *m.* shpatë. *E preu me këllëç.*
- këlürem** *jovep.* kënaqem. *U këlura me gjellë.*
- kënditem** *jovep.* ngopem. *U këndit me gjellë.*
- kërcëllím/ë -a** *f.* zhurmë e fortë.
- kërçëmá** *ndajf.* copë-copë. *I bënë kërcëma.*
- kërkál/e -ia** *f.* këmborë e vogël.
- kërre** *mb.* e qartë. *Hëna është kërre.*
- kërréj** *kal.* nxjerr. *Kërrej pulat nga kopshti.*
- këshmé** *kal.* kishim. *Keshmë dasmë.*
- ki**, për ky.
- kíçar -i** *m.* kërraç; kiçar gomari.
- kíl/ë -a** *f.* kulaç. *Ndahet kila nga kulaçi.*
- kísfer -i** *m.* skifter. *Kisferi mori një pulë.*
- klibáz/ë -a** *f.* gëlbazë.
- kllók/ë -a** *f.* e vjetër.
- kllëngëqe** *mb.* e papjekur. *Bukë kllëngëqe.*
- koçonár -i** *m.* kockë në kyçet e këmbëve.
- koftó -i** *m.* grurë i shtypur. *Bëra kofto.*
- kokálle -t** *f.sh.* kocka. *I mbetën kokallet.*
- kokëglúç -i** *m.* kokëvogël. *Është kokëgluç.*
- kolís** *kal.* ngjit. *Ju kolis djalit.*

- konák -u** *m.* shtëpi. *Bëri konak.*
kondopérr/e -ja *f.* shkurre që ka gjemba.
konopic/ë -a *f.* shkurre. *I lidha me konopicë.*
kopedh/ë -a *f.* vajzë.
koráq -i *m.* lypës. *Është koraq.*
korojdh/i -a *f.* grua që flet me të tallur.
korsh/é -ja *f.* dantellë. *Bëri korshe.*
koshadhe -ja *f.* përmb. xhandarë.
kosht -i *m.* kopsht. *S'kërren pulën nga koshti.*
krajlí -a *f.* mbretëri.
kreshmë -t *f.sh.* rit fetar; kohë kur kufizohet ushqimi.
kromëbíth/e -ja *f.* trëndafil i egër.
ksehasem *jokal.* argëtohem. *U ksehasa.*
ksenit/í -ia *f.* dhe i huaj. *Na hëngri ksenitia.*
ksér/ë -a *f.* thatësirë. *Ky vit bëri kserë.*
kseriké *mb.* i thatë. *Mbolla qepë kserike.*
kuhem *jovep.* acarohet lëkura. *Jam kuar.*
kúck/ë -a *f.* rrënjë shkurreje. *U bë kuckë.*
kuçumbéle -ja *f.* gur i vogël lumi ose deti.
kucúr/ë -a *f.* kërcu. *U dogj kucura.*
kufár -i *m.* gropa e gushës. *Më dhemb kufari.*
kuj/e -ja *f.* klithmë e fortë. *Vuri kujen.*
kuk/o -ua *f.* helmetë.
kúk/ë -a *f.* kokë. *Qe lavosurë në kukë.*
kukëkazán -i *m.* kokëmadh.
kukëxáthur *mb.* i pambrojtur; i zbuluar.
kukúdh -i *m.* figurë mitologjike; lugat.
kukuzekthi *ndajf.* duke u grindur ose duke u shtyrë (për njerëzit).
kulish -i *m.* këlyshi.
kullej/ë -a *f.* kullësë; enë me vrima.
kullúsm/ë -a *f.* vend me shkurre të dendura.
kumandój *kal.* komandoj.
kumbísem *jovep.* mbështetem. *Rri kumbisur në mur.*
kundra -t *f.sh.* këpucë. *Gjithë me kundra pazari.*
kundi *ndajf.* kudo.
kundrashtoj *kal.* kundërshtoj.
kundruall *ndajf.* përkarshi.
kúnjë -a *f.* shtrat fëmijësh që përkundet.

kuqál -i *m.* me qime të kuqe.
kúqël/ë -a *f.* dardhë e kuqe.
kurásmë *mb.* i ngrirë.
kurkuviq *ndajf.* kruspull.
kút -i *m.* matës gjatësie. *Kut druri për pila.*
kutërboj *kal.* mbaj erë të keqe. *Kutërboi dynjanë.*
kuturis *jokal.* guxoj. *Kuturis për çdo punë.*

L

lahárjep *mb.* që i kanë rënë pendët.
lákth -i *m.* pjesa e brendshme e gjurit.
lanét -i *m.* mallkim. *Ç'ish ajo ditë laneti!*
larásh -i *m.* zog me lara.
larémúshk/ë -a *f.* dhi e murrme me lara.
lár/o -ua *m.* qen.
láshtit *ndajf.* në kohë të vjetër. *Lashtit ishin në çeta.*
lashtërisht *ndajf.* në kohë të largët.
latúar (i) *mb.* i lëmuar.
lavós *kal.* plagos. *U lavos në kokë.*
leco *mb.* leckë. *E bënë leco.*
leftéros *kal.* liroj. *Lefterosa dhomën.*
lëfósër/ë -a *f.* lëvore.
lémë -i *m.* sheshi; lëmi, ku shihej gruri.
leméndo *mb.* dyshues. *U bëra lemendo.*
leméri -a *f.* tmerr.
leondár -i *m.* luan; i fortë.
leqendí -a *f.* dobësi, tallje.
limós *kal.* kruaj, lëmoj. *Limos bishtin e lopatës.*
litirjó *mb.* i hidhur. *Ju bëftë litirjo.*
litérví -a *f.* mulli vaji.
livédhje -ja *f.* shushunjë. *Ju ngjit si livedhe.*
lovídhe -ja *f.* bishtajë, mashurka.
lubí -a *f.* gjarpër i pangopur me disa kokë.

LL

llabán/e -ja *f.* veshje pa mëngë me lesh dhie.
llaj/ë -a *f.* dele ose lopë krejt e zezë.
lláll/ë -a *f.* dhallë. *Piva një kupë me llallë.*

llát/ë -a f. teneqe me grykë të ngushtë.
llavurdís kal. merr e ha pa hesap.
llomié -ja f. baltë e gurë që sjellin lumenjtë.
lluburdír/ë -a f. gjë e turbullt.
lláj/ë -a f. dele e zezë. *Çoban me llaja.*
llajúsh m. dash i zi. *Llajushin më hell e kanë.*
llamikárur (i) mb. i zier dy herë.
llarmëra ndajf. copë-copë. *U bënë llarmëra.*
lláspë f. baltë. *U bë gjithë llaspë.*
lluvínjë -a f. enë alumini. *Zieva në lluvinjë.*

M

maç -i m. maçok. *Ikën me kuç e me maç.*
mágje -ja f. govatë. *Bëra bukë në magje.*
mahí -të f. trarë nga streha në kulm.
mallafrac -i m. sëmundje. *I doli mallafraci.*
mandát/ë -a f. lajm i vdekjes.
mandil/é -ja f. shami koke.
mandilebardhë mb. shami koke e bardhë.
mandilézë mb. shami koke e zezë.
mánxh/ë -a f. mall, pasur. *Gjeti manxhë.*
mardhë -a f. brengë. *Ka mardha.*
mashán -i m. kaci; vegël që trazon prushin.
mastór -i m. usta. *Punon si mastor.*
matrák -u m. vegël që mënjanon prushin.
mavri -a f. ngjyrë e zezë. *Ngjeva në mavri.*
mázh/ë -a f. dele kokëzezë në kafe.
mbállos kal. arnoj këpucët; u vë mballomë.
mbarsélís/e -ia mb. erë që sjell lulëzimin.
mbódhisurë (e) mb. shtatzënë.
mbrát/ë mb. barsë.
mbráz kal. zbraz. *Mbraz enët.*
mbrëmánet ndajf. në mbrëmje.
mbríh kal. vë në punë.
mbróth ndajf. mbarë, përpara.
mbrúj kal. ngjesh brumë.
mbrúme (e) mb. e zënë me brumë të thartuar.
mëmë -a f. nënë.

mëhállë -a *f.* lagje ose fis. *Mëhalla e Qurke.*
melaqé -ja *f.* engjell; orët, zanat, zërat.
mellan -i *m.* bojë. *I doli mellani.*
mellúr/ë -a *f.* vrug. *Hardhitë kanë mellurë.*
mëllë -ri *m.* kafshatë buke.
mëmëzôte -ja *f.* gjyshe.
menátë *ndajf.* herët në mëngjes.
mënd/e -ia *f.* mendje.
mënój *jokal.* vonoj. *U mënuua puna jote.*
mbrajthe *f.* lloj barishte që hahet e zier.
mërqínj/ë -a *f.* shkurre me gjemba të fortë.
mështëngem *jovep.* shmangem. *U mështëng.*
metabáshkë *ndajf.* me vrap.
mëtëlárti *ndajf.* përpjetë.
mëtëpóshtë *ndajf.* teposhtë.
módrua *ndajf.* mos. *Modrua, more modrua.*
mollóis *kal.* tregoj.
móraitë *mb.* nga Moreja, Poloponezi.
motëmót -i *m.* vit.
motmoçar *mb.* motak, njëvjeçar.
mudhist/ër -ra *f.* rrobaqepëse.
muharrebé *mb.* luftë, kaos.
mukavalát *m.* mbledhje. *U bë mukavalat.*
múll/ë -a *f.* farë djathi. *Zuri mullë.*
múng -u *m.* buzëmbërënjë.
munx/ë -a *f.* bravë ose paçet.

N

nakatós, kal. përziej.
namúsqar *mb.* serioz, i ndershëm.
napulitán *mb.* napolitan.
ndaí *ndajf.* tani. *Erdhi ndai.*
ndashtí *ndajf.* tani. *Le t'i gjejnë ndashti.*
ndez *kal.* ngec. *Ndeza në mësim.*
ndih *kal.* ndihmoj. *Vajta për të ndihur.*
ndris *kal.* shtyp. *Ndris lakrat.*
nënbark/e -ja *f.* rrip nën barkun e kafshës.
nëndur *ndajf.* dendur. *I mbolla nëndur.*

ngála *ndajf.* e mban në kurriz.
ngallón *kal.* degjeneron bima. *Fara ngalloi.*
ngashëret/ë -a *f.* ngashërim. *E qau me ngashëretë.*
ngeja *ndajf.* ironi. *Ka shumë ngeja.*
ngoje *f.* në gojë. *Nuk e zuri ngoje.*
ngjat *kal.* zgjat. *Ngjati këmbët.*
ngjëktë *ndajf.* “gjetkë. *Do rrijë ngjëktë.*
ngjithë *përem.* gjithë. *Ngjithë bashkë.*
nijét -i *m.* qëllim. *Ka nijet të bisedojë.*
noksán *mb.* i prapë.
nóme -ja *f.* stallë e bagëtive.
nur -i *m.* dritë, yll. *I ra një nur.*
nurít *kal.* heton, pyet.
nxhík/ë -a *f.* vajzë e veshur bukur.
nxí *jokal.* nxin. *Nxi Ara e Gjatë.*

NJ

ngjerthellós *kal.* rrethoj.
njëdíaj *ndajf.* pardje.
njëra *parafj.* deri. *Trahana njëra më lëmë.*

O

ohú *pasth.* moskokëçarje. *Ohu dhe ti!*

P

padisháh -u *m.* sulltani.
paksëpáku *ndajf.* jo më pak se...
palikár *mb.* trim.
palça *f.* paçe. *E bëri palça.*
pallásk/ë -a *f.* vezme për fishekë dhe barut.
palldëm -i, *m.* rrip për kafshë nën bark.
paraník/e -ja *f.* bukë misri.
paraponí -a *f.* mërzy.
parthí *ndajf.* më parë; qëparë.
parí -a *f.* pleqësia. *U mbloodh paria.*
pashtullíz/ë -a *f.* papastërri.
papúl -i *m.* gjysh.
pataks *kal.* çudit. *U pataksën, u çudinë.*

- patashóre** *mb.* e rrafshhtë.
path/uá -oi *m.* mjek popullor.
paúdhë (i) *m.* djall, shejtan.
pedháq -i *m.* djalë.
pëgërë (i) *mb.* i ndotur.
pëjés *kal.* pyes. *Në pëjeçin për mua.*
pëlír, *kal.* ndot.
pëllát/ë -a *f.* bagëti me qumësht.
pëllúa *mb.* i gjallë, i tërë.
pëqí -ri *m.* prehër. *E mbajti në pëqi.*
përbísht/e -ja *f.* druri, dajaku.
përç -i *mb.* cjap i patredhur.
përckalís *kal.* ngatërroj. *Përckalis dynjanë.*
perivol -i *m.* kopsht me pemë.
përkaldh/e -ja *f.* lakër e egër e ngrënshme.
përmís *ndajf.* përmbys. *Ra përmiss.*
përpósh *ndajf.* poshtë.
përráll -i *m.* lloj shkurreje.
përzitës -i *m.* ai që bashkon bagëtitë me ato të një tjetri për t'i kullotur së bashku.
peshllí *m.* veshje burrash me mëngë të çara.
psoj *kal.* mësoj. *Psoj fëmijët në shkollë.*
pifar -i *m.* lloj fyelli, culë dyjare.
pícunar -i *m.* burim uji në shkëmbinj.
pikërim *m.* i hidhur. *Është pikërim.*
pikëronem *jovep.* hidhërohem.
piktó *ndajf.* pa lëng. *Është pikto.*
píll/ë -a *f.* qyp i madh me vaj.
píshk -u *m.* peshku.
pisqóset *jovepr.* bëhet gati.
plasëbuz/e -ia *f.* fatkeqësi, mundim i madh.
platothíq -i *m.* vend ku vihen pjata.
pléhë *m.* pleh. *U hodha pléhë.*
pllakós *kal.* i bie përsipër, e mbuloj.
pllangje -ja *f.* pëllëmbë. *I dha dy pllangje.*
pllaqush -i *m.* i sheshtë.
pllockár -i *m.* dryn.
poftís *jokal.* i bie në qafë pa të drejtë.

poktís kal. sjell. *Poktis kudo.*
potís kal. ujit. *Potisa lulet.*
pogániq/e -ja f. gosti; vakt buke.
póllk/ë -a f. bluzë grash me kopsa.
popël -a f. gur i madh.
potís kal. ujit.
poturebrán mb. që mban zvarrë poturet.
prêhem jovep. shlodhem.
prëmë ndajf. mbrëmë.
proshqefáll/ë -a f. jastëk, nënkrejë.
protójen -i mb. kec që e ka mbushur vitin.
protokál/e -ia f. portokalle.
psónem jovep. mësohem.
psonís kal. bëj pazarin.
pulqér -i m. gishti i madh i dorës.
pungj -i m. grusht. *E goditi me pungj.*
pungjal -i mb. kec apo qengj pirës.
purríq -i m. lloj lakre si qepë e egër.
pusí -a f. pritë në shteg. *I zunë pusinë.*

Q

qásem jovep. afrohem.
qélq -i m. gotë.
qép/ër -ra f. tra që mbërthehet në kulm.
qepélák -u mb. i varfër, i veshur keq.
qépr/ë -a f. tra anësor, dërrasë.
qerdhés kal. përfitoj.
qerthëllój kal. rrethoj.
qiamét -i m. përmbysje.
qiç -i m. kyç, çelës.
qilí -a f. qilim, rrugicë e endur.
qíll/o -ua m. kilogram.
qimúr -i m. qymyr.
qísh/ë -a f. kishë.
qosëvënd -i m. që është i zoti për çdo gjë.
qotí -a f. i mefshtë; i frikshëm.
qullásh -i m. gatim me miell, vaj ulliri, djathë.
qullash mb. i pazoti; i qullët.

R

raj/é -a f. përmb. të nënshtruar; robër.

ráqi -a f. raki.

rékím -i m. rënkim.

rékúth -i m. i ngjitur pas dikujt.

repíc/é -a f. lloj lakre e egër që hahet e zier.

rigat/é -a f. mbretëri. *Vjen Himara si rigatë.*

rirë pjes. hyrë. *I kish rirë dreqi.*

rizogáll/é -a f. oriz me qumësht.

rodín/é -a f. fara, soji. *Ju shoftë rodina!*

rubák/e -ja f. bagëti që i ka rënë leshi.

rúqe -ja f. grua e shkurtër.

RR

rrahës -i m. dru për të rrahur rrobat.

rrázhd/é -a f. copë mjalti me hoje.

rreck/é -a f. leckë. *E bëri leckë.*

rrëk/é -ja f. vijë e vogël uji.

rrëmb -i m. damar uji.

rrëmbúshem jovep. mallëngjehem.

rém -i mb. ndryshk. *Të bakërta me rem.*

rrëmój kal. gërmoj. *Rrëmoj në kopsht.*

rrëmúll/é -a f. rrëmujë. *Shtëpi rrëmullë.*

rrënxak -u m. i rrënxuar.

rrëvizhd/é -a f. rastësi. *Ishte rrëvizhdë.*

rrëthós kal. rrethoj.

rrufull/é -a f. rrotullim uji në formë rrethi.

rrukúnis kal. rrukullis. *Si kaçup u rrukunis.*

rrushkál/e -ja f. rrush kokërrvogël.

S

sabá m. mëngjes. *Në saba pa dalë dielli.*

sadrazém -i m. kryeministër.

sakáq -i m. xhaketë.

salltanét -i f. pasuri, madhështi.

sanxhák -u m. prefekturë.

sapúnd- i m. sapun.

sarahósh -i *m.* pijanec dhe prishës.
savan -i *m.* pëlhurë që mbulojnë të vdekurin.
sebép -i *m.* shkak. *E gjeti sebepin.*
sehír *m.* vështrim nga larg. *Bëj sehir.*
selít *kal.* u shërbej pemëve, vreshtit.
sëllíj *jokal.* ha mëngjesin.
sendón -i *m.* çarçaf.
serasqér -i *m.* komandant i një ushtrie.
sevdá -ja *f.* dashuri. *Më hodhe, moj sevda.*
siçakërr *mb.* syvëngër; vëngarash.
síll/ë -a *f.* vakti i mëngjesit.
sindaí -a *f.* recetë.
sinór -i *f.* kufi.
sirá -ja *f.* radhë.
sírm/ë -a *f.* tel.
sísk/ë -a *f.* dele me sy të zes ose kafe.
sismó -i *m.* tërmet. *fig. U erdhi sismoí.*
sjétull/ë -a *f.* sqetull.
skalís *kal.* punoj tokën me sqepar.
skolí -a *f.* shkollë. *Djemtë e skolisë.*
skutín/ë -a *f.* pelenë. *Skutinat i mori lumi.*
soró -i *m.* grumbull. *I bënë soro.*
sorovollóçka *ndajf.* rrëmujë.
sorqeth *m.* sorkadhe. *Si sorqedh janë mileti.*
sos *pjes.* se mos. *Sos për mua a për ty.*
spálorë *ndajf.* bosh. *Kodra është spalurë.*
spudhí -a *f.* mësime, dituri.
sqiftér -i *m.* skifter.
squr/é ja *f.* enë kuzhine; tas i madh.
strúnx/ë -a *f.* pëllëmbë. *I dha një strunxë.*
stér/e -a *f.* tokë. *Doli në stere.*
stipendár -i *m.* rrogëtar në ushtritë e huaja.
stolí -a *f.* zbukurim.
stratígo -i *m.* gjeneral, ushtarak i shquar.
stratiót -i *m.* ushtar.
strëmëkuqem *jovep.* marr ngjyrë të kuqe.
strëmënxë *f.* rrëmujë. *I la strëmënxë.*
stróm/ë -a *f.* dyshek.

strungulís *jokal.* ndrydh. *Strungulisa këmbën.*
súa, soji *m.* fis.
sojmë (i) *mb.* i fismë. *Janë të sojmë.*
sufrán -i *m.* sofër. *Hëngrëm bukë në sufran.*
súj/ë -a *f.* bixhak. *Më ra suja.*
sulín/ë -a *f.* tub bosh.
surgjund *mb.* syrgjyn; i larguar.

SH

shahít -i *m.* dëshmitar.
shakúll -i *m.* lëkurë e bagëtive për të mbajtur bulmet.
shapí -u *m.* zhapik.
shark -u *m.* bërruc, veshje e çobanëve.
shelég -u *m.* qengj. *Jam bari me shelegë.*
shelqëror -i *m.* dru; shtyllë ku varej djathi.
shëmëhill -i *m.* nëntor.
shëmít/ër -ri *m.* tetor.
shëndro *mb.* i paaftë.
shënëndré -u *m.* dhjetor.
sheprák -u *m.* derëmbyllur.
shërr/ë -a *f.* sharrë.
shigúp -i. *m.* njeri i shëndoshë.
shít/ë -a *f.* dhi pa brirë.
shuaj *jokal.* vdes, më lë fryma. *Shoi para një ore.*
shóll/ë -a *f.* opinga. *Bleva një palë shollë.*
shpatúllërisht *ndajf.* pjerrtas.
shqédhjo *m.* model.
shqopísht/ë -a *f.* vend me shqope.
shtálp/ë -i *m.* djathë pa u hedhur në napë.
shtërpój *jokal.* shteroj.
shtëmëng *kal.* shmang. *Shtëmëng rrugën.*
shtréth -i *m.* rrethimi i kasolles së stanit.
shtrúng/ë -a *f.* vathë për mjeljen e bagëtive.
shtúp/ë -a *f.* fije që mbushen dyshekët.
shull/ë -ri *m.* vend që rrihet nga dielli.
shúr -i *m.* zhavorr.
shurmbret *-i* *m.* çift. *Janë shurmbret.*
shutru- kutru *ndajf.* kot. *Flet shutru-kutru.*

T

tabiját -i *m.* zakon, ves. *E ka tabijat.*

tabórr -i *m.* batalion me njëqind ushtarë.

tákëm -i *m.* grup njerëzish. *Erdhën një takëm.*

taksirát -i *m.* hall; na zuri taksirati.

tálër -i *m.* fuçi druri për ullinj.

táraf -i *m.* fis, grup njerëzish me interesa të përbashkëta.

tartapósh *m.* lartësi, në vend të dukshëm.

tát/ë -a *m.* baba.

teferiç *ndajf.* për qejf, pa adresë. *Ka dalë teferiç.*

ténë *përem.* tonë.

ténj/ë -a *f.* sëmundje, teshtitja e qenve.

tèrkúl -i *m.* sfurk druri me dhëmbë.

tertúp -i *m.* organizim i fshehtë.

teslím -i *m.* dorëzim; shpërbërje.

tiganiç *kal.* tiganis, skuq.

timí -a *f.* nder. *Të madh i bënë timinë.*

tirí *m.* djathë. *Psonisa tiri.*

tóba *ndajf.* lirshëm. *I lëshoi dhitë toba.*

tojbetís *kal.* mallkoj. *E tojbetisi për dynja.*

tramundán/ë -a *f.* stuhi, erë e perëndimit me shi dhe rrufe. *Si zogjtë në tramundanë.*

trapúlla -t *f.* letra. *Bëmë një dorë trapulla.*

trástamadh -i *m.* vjedhës.

treshore *mb.* trevjeçare. *Dhi treshore.*

trúar (i, e) *mb.* i, e ndrojtur. *Vjen e truar.*

TH

thark -u *m.* vend ku mbahen keçërit e vegjël.

thèrmók -e *f.* djathë i shkoqur.

thío, -ja *m.* dajo.

thóllo -ja *f.* bodrum; me kubaturë të lehtë.

thómse *jokal.* ndoshta. *Thomse do të vijnë.*

thrépsem *jovep.* kënaqem. *Threpset më diell.*

U

ú *përem.* unë. *U vajta krushk.*

ú -ja *f.* uri. *Më mori uja.*

urát/ë -a f. bekim, e bekuar. *Mori uratën.*
úshe f. një e dhënë, indicie. *Kam një ushe për këtë problem.*
uthullúar (i) mb. që është bërë uthull.
uxhúm pasth. sulm.

V

vandáqe ndajf. turp. *Bëri vandaqe.*
vangullón jokal. shikon pak. *Mezi vangullon.*
várem jovep. zbres. *Sot u varçë nga kroi.*
vatán -i m. atdheu; vendi ynë.
védr/ë -a f. kazan llamarinë për mjeljen e bagëtive.
vëlçéz f. lëndë që del nga sëmundje stomaku. *Nxori vëlçez nga stomaku.*
venét -i m. venetik. *Venet e napolitanë.*
venóme -t m.sh. të drejtat e Himarës për 450 vjet.
verbáz ndajf. verbërisht. *Beson verbaz.*
verém -i m. turbelokoz. *I hëngri veremi.*
vergjí -a f. taksë për shtëpi.
vërrí -u m. vend i ulët; kullota dimërore.
vërshëllej kal. fishkëllej.
vërvítem jovep. sulem. *U vërvinë.*
veshélépur -i mb. insekt i zi me trup të gjatë.
vëshj/ë -a f. veshkë. *Hëngra një veshjë.*
véshtull/ë -a m. lloj gjarpri që lëviz ngadalë.
víck/ë -a f. shkelm që hedhin kafshët.
vriz -i m. burim. *Piva ujë nga vrizi.*
vithis kal. rrëzoj. *Ka nijet që ta vithisë.*
vitór/e -ia f. bollë; gjarpër i shtëpisë.
vivlí -a f. libër.
vjanxë ndajf. shans. *Erdhi një vjanxë.*
vjérrë (i) mb. që varet poshtë.
vllápsëm jovep. mërzitem, lëndohem.
vóve -ja f. vuajtje.
vozdole f. dembele. *Është vozdole.*
vréng ndajf. menjëherë.
vrokollák -u mb. hamës i madh.
vuléhúmbur mb. i mefshtë.
vúpe ndajf. me shumicë. *I dhashë me vupe.*

vurrát/ë -a f. shenjë që mbetet nga goditja.

vër/ë -a f. vrimë guri.

X

xanxáre -ja f. që godet me shqelma.

xáthur ndajf. zbathur.

xbres jokal. zbres.

xerk -u m. zverk.

xgárbë -a f. zgavër.

xudhí ndajf. lodra. *Na bën xudhi.*

xullúf/e -ja f. flokë mbi ballë

XH

xhallár mb. bujar. *Është xhallar.*

xhambúlle f. rrëmujë. *E bënë xhambulle.*

xhán -i m. shpirt; i doli xhani.

xharáp/e -ia f. çorape.

xhelalém -i m. popullsia.

xhësh kal. zhvesh.

xheváp -i m. përgjigje; më jep xhevap.

xhixhobull/ë -a f. grua e vjetër; hallë.

xhizé -ja f. taksë për popullsinë e krishterë.

xhudám -i m. i humbur.

xhumá -ja f. e premtë.

xhurmét mb. mikpritës.

Y

ymër -i m. jetë. *Paç ymër e shëndet.*

Z

zabít -i m. oficer.

zahár -i m. sheqer.

zehér -i m. helm. *U bë zehër.*

zengjin -i m. i pasur; pasanik.

zó -ja f. kafshë. *Ishtë zo.*

zográfis kal. vizatoj.

zoí -ja f. jetë. *S'është e mirë ajo zoi.*

zër/ë -a f. zanë.

ZH

zhérm/ë -a f. llucë, pisllek. *U bë zhermë.*

zhgráps kal. shkruaj me shkrim të keq.

zhíer (i) mb. i ndotur.